



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:241592
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05837642

K.Dh.Sh II.nr.543/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbarimore të kreditorit Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “TehnoBurimi” DD SH.A., me numër unik identifikues 810548307 dhe seli në Shupkocv, Komuna e Mitrovicës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Dijar Dinaj, avokat nga Mitrovica,, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1781/23 të datës 27.12.2023, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “TehnoBurimi” DD SH.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1781/23 të datës 27.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1781/23 të datës 27.12.2023, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “TehnoBurimi” DD SH.A., me numër unik identifikues 810548307, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 1384/2023, i lejuar më datë 08.10.2023, nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, sa i përket detyrimit për pagesën e kamatës ligjore prej 8% në vit, dhe në këtë pjesë procedura përmbartimore PËRFUNDOHET.

II.REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “TehnoBurimi” DD SH.A., me numër unik identifikues 810548307, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 1384/2023, i lejuar më datë 08.10.2023, nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, për borxhin në lartësi prej EUR 20,000.00 MBETET NË FUQI.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë, ta refuzoj kërkesën e kreditorit ashtu që të hudh Urdhrin Përmbartimor P.nr.1384/23 të datës 08.10.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozimin për përmbartim , mbi bazën e dokumentit përmbartimor; Vendimit 02 Nr. 22-150/2022 B, të datës 20.03.2023, ndërsa Përmbartuesi Privat Atip Mustafa ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 1384/2023, të datës 08.10.2023, me të cilin është obliguar debitori “TehnoBurimi” DD SH.A., që kreditorit t’ia

paguaj shumën prej EUR 20,000.00 në emër Vendimit Administrativ, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitorit, brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri është i pakuptueshëm dhe se gjoha është shqiptuar në mënyrë paushallë. Ndërsa, ka shtuar se ndaj të njëjtit vendim ka paraqitur ankesë mirëpo që ende nuk ka pranuar vendimin e organit të shkallës së dytë, ashtu që vendimi për të cilin kërkohet përmbushja nuk është i plotfuqishëm. Në fund, ka theksuar se vendimit në fjalë i mungojnë tiparet e përmbartueshmërisë të përcaktuara në LPP, dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm, andaj gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara, ngase i njejtë e ka pranuar vendimin e shkallës së dytë çka vërtetohet nga flete kthesa R 2892633 e datës 25.08.2023. Ndërsa, sa i përket pretendimeve se vendimi nuk është i ekzekutueshëm, ka theksuar se në bazë të nenit 6.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës, ankesa e ushtruar nuk e shtyn ekzekutimin. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1781/23 të datës 27.12.2023, duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përmbartimor P.nr. 1384/23, i datës 08.10.2023, sa i përket obligimit të debitorit për pagesën e kamatës ligjore prej 8% në vit, nuk është në përputhje me dokumentin përmbartimor, pasi që me vendimin Vendimit 02 Nr. 22-150/2022 B, të datës 20.03.2023, debitori është obliguar që të paguaj shumën EUR 20,000.00, në emër të masës ndëshkimore, mirëpo jo edhe kamatën ligjore prej 8%. Prandaj, gjykata vendosi që ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor për pjesën e kamatës së kërkuar ligjore në larti prej 8% në vit, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dsipozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti përmbartimor, përkatësisht Vendimi nr. 1384/23, i datës 08.10.2023, mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri

përmbartimor, sipas nenit 22, pika 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se dokumenti mbi bazën e së cilave është lejuar përmbartimi paraqet titull ekzekutiv ashtu siç kërkohet me nenin 21 të LPP-së *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”* dhe nenit 36 par. 1 i cili përcakton se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”, të LPP-së.*

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, dokumenti- Vendimit 02 Nr. 22-150/2022 B, të datës 20.03.2023, konsiderohet si dokument i besueshëm, pasi që i njëjti përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të datës 17.08.2023 si dhe është paraqitur në origjinal. Ndërsa, sa i përket pjesës së kamatës ligjore prej 8% debitori me vendimin Vendimit 02 Nr. 22-150/2022 B, të datës 20.03.2023, është obliguar që të paguaj shumën EUR 20,000.00, në emër të masës ndëshkimore, mirëpo jo edhe kamatën ligjore prej 8%.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore

eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Sh.II.nr.473/24 , me datë 19.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri